

**DEKLARATË**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, (emri atësia mbiemri) lindur më \_\_\_\_\_  
me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë \_\_\_\_\_ ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve të arsimit të lartë në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Institucionin e Arsimit të Lartë ku kam aplikuar, ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet e arsimit të lartë, ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.
2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord.
4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe/ose institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

\_\_\_\_\_  
Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Firma:

Vendi: \_\_\_\_\_